



Pranimi / Deregullim / Primeshje / Pristje / Recieve / Deregulation	06.04	2022	2	viti / god / year
Organ / Shkronja / Organ / Shkronja / Org. / Unit	1914/2022			
Shifra e Prirje / Appendix				
Sasia / Kohëzina / Quantity				1/4

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.233/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca anëtar, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas aktgjykimit A.nr.1212/19 të datës 22.03.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështjeje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.233/2019, të datës 08.04.2019, të ankuesit me adresë banimi nga

organit të punësimit Gjykata Themelore Gjakovë, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 06.04.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.233/2019, e datës 08.04.2019, e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi KA.nr.4/19, i datës 07.03.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjakovë.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë dega në Rahovec, në pozitën „Arkivistë“, sipas akt emërimit të datës 01.01.2013, me datë 01.03.2019, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Themelore në Gjakovë, me pretendimet ankimore për kompensimin e pagës për punën shtesë referent për certifikata për vula apostile, sipas shkresës së datës 33/2009 të datës 31.03.2009, të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Rahovec.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjakovë, me datë 07.03.2019, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar në ligj.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me vendimin KA.nr.4/19 të datës 07.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjakovë, me datë 08.04.2019 dhe numër protokollit 1803/2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin në vazhdim Këshilli), me datë 03.09.2019, dhe numër protokollit 4086/2019, ka njoftuar ankuesin [redacted] se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A.nr.233/2019, të datës 08.04.2019, për shkak se Këshilli nuk është funksional në mungesë të anëtarëve, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit, ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 22.03.2022, A.nr. 1212/19, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, me të cilin ka anuluar njoftimin me nr.ref.A.nr.233/2019 të datës 03.09.2019, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.233/2019, të datës 08.04.2019, të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e vendosjes meritore të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.233/2019, e datës 08.04.2019, me numër protokollit 1803/2019 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A.nr.1212/19, i datës 22.03.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesa për kompensim të pagës shtesë e datës 31.01.2019; Përgjigje në kërkesë e datës 12.09.2018 me nr.ref.AGJ.I.357/18; ankesa e datës 01.03.2019 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjakovë; Vendimi KA.nr.4/19 i datës 07.03.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjakovë; kërkesë për kompensim të pagës shtesë, drejtuar Gjykatës Themelore në Gjakovë dega në Rahovec e datës 31.01.2019; kërkesë për kompensim të pagës shtesë, drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës e datës 17.09.2018; Përgjigje në kërkesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor e datës 27.09.2018 me nr.03/619; kërkesë për kompensim të pagës shtesë, drejtuar Gjykatës Themelore në Gjakovë dega në Rahovec e datës 09.10.2018; shkresa zyrtare e datës 06/03/2009 me nr.ref.03/031-276 e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor; shkresa Agj.nr.33/2009 e datës 31.03.2009 nga kryetari i Gjykatës komunale në Rahovec; dy çertifikata të gjykatës themelore në Gjakovë dega në Rahovec sipas renditjes në lëndë 20 dhe 21, në lidhje me evidencat penale dhe vulat apostile; Akt Emërimi i datës 01.01.2013; Vendimi i datës 26.12.2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 03.09.2019 i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 23.04.2019, me numër protokollit 2008/2019; Vendimi i Këshillit A.nr.765/2018 i datës 26/12/2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **pabazuar, sepse;**




Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar Aktgjykimin e datës 22.03.2022, A.nr.1212/19, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim e ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019 të Këshillit, me të cilin aktgjykim Këshillin e ka obliguar që të vendos lidhur me ankesën A.nr. 233/2019, të datës 08.04.2019 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi [redacted] [redacted] punësuar në pozitën „Arkivist“, në Gjykatën Themelore në Gjakovë dega në Rahovec, sipas akt emërimit të datës 01.01.2013, ka kryer edhe detyra shtesë respektivisht referent për përdorimin dhe nënshkrimin e vulave apostile pranë kësaj Gjykate, sipas shkresës nr.33/2009 të datës 31.03.2009, të Kryetarit të Gjykatës Komunale në Rahovec, me të cilin e ka autorizuar edhe ankuesin [redacted] si person përgjegjës për përdorimin dhe nënshkrimin e vulave apostile, mirëpo Kolegji duke ju referuar shkresës-përgjigjes në kërkesën e datës 05/09/2018 të Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, kërkesës së datës 17/09/2018 ,përgjigjes në kërkesë të datës 27/09/2018 të zyrës së Personelit të sekretariatit gjyqësor të Kosovës, kërkesës së datës 09/10/2018 dhe kërkesës së datës 31/01/2019 drejtuar Gjykatës Themelore në Gjakovë, kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës dega në Rahovec ka konstatuar se ankuesi ankesën e ka parashtruar me datë 01.03.2019, te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjakovë, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar për parashtrimin e ankesës sipas dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ankuesi është ngarkuar me këto përgjegjësi shtesë dhe të cilit i ka filluar afati ligjor i të drejtës për realizim eventual të kërkesës .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesën ka konstatuar se ankuesi ankesën me datë 01.03.2019, e ka parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Gjykata Themelore në Gjakove, lidhur me kompensimin e pagës shtesë lidhur me kryerjen e detyrave shtesë “Referent për përdorimin dhe nënshkrimin e vulave apostile”, sipas shkresës së datës Agj.nr. 33/2009 të datës 31.03.2009, të Kryetarit të Gjykatës Komunale në Rahovec, e që është jashtë afatit ligjor, të paraparë sipas nenit 130 paragrafin 1 pika a) të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative i cili ka qenë në fuqi në këtë kohë, i cili përcakton se: **“130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin”,** si dhe jashtë afatit të paraparë me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, i cili përcakton se: **“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me rastin e shqyrtimit të këtij vendimi, ka konstatuar se në preambulë të këtij vendimi gabimisht komisioni i referohet përveç tjerash edhe Ligjit të Punës Nr.03/L-212,poashtu në hyrje të arsytimit të këtij vendimi gabimisht është e potencuar data e parashtrimit të ankesës 06/02/2019,ndërsa data reale e parashtrimit të ankesës është 01/03/2019,ndërsa duke pasur parasysh edhe faktin se nga përmbajtja e shkresave të lëndës konstatohet se kemi të bëjmë me një të drejtë që bazohet në shkresë të datës Agj.nr. 33/2009 të datës 31.03.2009,të Kryetarit të Gjykatës Komunale në Rahovec, ndërsa vendimi i komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave është i datës 07/03/2019, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore në



Gjakovë, me rastin e nxjerrjes së Vendimi, KA.nr.4/19 të datës 07.03.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative ,dispozitave të specifikuara më lartë dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, nga se nuk ka trajtuar sipas bazës ligjore afatshmerinë e ankesës së ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjakove dhe mbi këtë arsye edhe vendimi është i pabazuar, andaj edhe mbi këtë bazë është shfuqizuar ky vendim që është i atakuar përmes kësaj ankesë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave,pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hy në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.233/2019,datë 06.04.2022

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Themelore në Gjakovë;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së